- **M. Jean-Alain Jouan**, de nationalité française, né le 09.04.1954, à Saint-Malo, passeport n. 03VH38945,
- **M. Edvin Murati**, de nationalité albanaise et française, né le 12.11.1975, à Tirana, résident à Tirana, connu par moi le notaire;
- **M. Aleksander Xhuvani**, de nationalité albanaise, connaisseur de la langue française, né le 20.02.1955, à Tirana, carte d'identité n. 024942066,
- **Mme Elisabeth Gjoni**, de nationalité française, née le 03.08.1972, à Tirana, Albanie, passeport n. 04BI47457, dans la qualité de représentant légal de « Amadeus Group » Sh.a., basé sur la décision du date 1 septembre 2011, immatriculé auprès du centre national de registration d'Albanie avec numéro d'identification (NUIS) J72118005P;

Toutes les personnes susmentionnées, sur l'identité desquelles j'ai pris connaissance par les documents d'identification présentés, sont majeures et avec capacité juridique d'agir.

Ces personnes me déclarent, en la présence du traducteur de la langue français Oltion Spiro, avoir préparé le document ci-joint Statuts de l'association « Club d'Affaires France – Albanie » et qu'avec leur propre volonté le signent en ma présence.

NOTAIRE


JULIAN ZHELEGU

TRADUCTEUR

Oltion Spiro



STATUT



Shoqata

"CLUB D'AFFAIRES FRANCE - ALBANIE"

Tiranë 2011

KAPITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Shoqata "CLUB D'AFFAIRES FRANCE - ALBANIE" (në vazhdim cilësuar - Shoqata) - organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse, e pavarur, apolitike, e Republikës së Shqipërisë, quajtur në vazhdim "Shoqata", themelohet në formën e shoqatës nga themeluesit e saj, quajtur në vazhdim "Themeluesit" me synimin që të realizohen qëllimet e Shoqatës dhe kryerjen e veprimtarisë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1.2 Selia: Bul. Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Tiranë, Shqipëri, Kulla nr. 19.

1.3 Emërtimi i plotë: Shoqata "CLUB D'AFFAIRE FRANCE-ALBANIE".

1.4 Afati: Shoqata është themeluar për një periudhë të pacaktuar.

1.5 Statusi ligjor: Shoqata është një entitet jo tregtar me personalitet juridik, e cila ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të krijojë degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi si dhe mund të krijojë qendra të specializuara këshillimi, të kryejë veprimtari botuese dhe veprimtari të tjera sipas udhëzimeve dhe në interes të anëtarëve të saj.

1.6 Shoqata ka një letër me kokë dhe një logo, e cila është përcaktuar nga Shoqata, në përputhje me ligjin, një vulë dhe materiale të tjera të nevojshme për veprimtarinë e saj. Sigla dhe logo-ja janë si më poshtë:



Sigla: CFA

1.7 Çdo ndryshim ose modifikim i këtij Statuti ka fuqi ligjore ndaj palëve të treta nga momenti i regjistrimit të ndryshimeve në Regjistrin e organizatave jofitimprurëse.

1.8 Shoqata është e detyruar të deklarojë në Regjistrin e organizatave jofitimprurëse brenda afateve të përcaktuara me ligj çdo modifikim ose ndryshim të Statutit, ndryshimin e selisë, ndërprerjen e veprimtarisë së saj dhe vendimin për likuidimin vullnetar, bashkimin dhe ndarjen, themelimin e filialeve dhe përfaqësive, ndryshimin e anëtarëve të organeve drejtuese si dhe kompetencat e tyre, emërimin dhe ndryshimin e likuidatorit dhe kompetencat si dhe ndryshimin e logos së Shoqatës.

1.9 Shoqata do të përdorë të gjitha të ardhurat e përfituara nga veprimtaria e saj për qëllimet e përcaktuara në Statut. Shoqata nuk do të përdorë asnjë pjesë të pronës ose të të ardhurave të saj për interesat e një anëtarë apo një themeluesi të Shoqatës apo të një personi privat.

1.10 Shoqata nuk do të mbështesë asnjë parti politike, grupim zgjedhor apo kandidat në lidhje

me çfarëdo funksioni pranë autoriteteve publike dhe nuk do te përdorë asnjë pjesë të të ardhurave ose pronës së saj për financimin e tyre.

1.11 Shoqata ka një pasuri të veçantë, të nevojshme për të kryer veprimtarinë e përcaktuar në Statut dhe merr përsipër çdo detyrim që lidhet me këtë pasuri.

1.12 Vendndodhja e veprimtarive: Shoqata ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

KAPITULI II - QËLLIMET E SHOQATËS DHE MËNYRAT E REALIZIMIT

2.1 Qëllimi i Shoqatës është që të promovojë dhe lehtësojë eksportet dhe investimet franceze në Shqipëri. **Ky qëllim do të arrihet nga Shoqata me ndihmën e mjeteve të mëposhtme:**

- Pjesëmarrje në fillimin, zhvillimin dhe promovimin e programeve të investimeve, të ristrukturimeve dhe të bashkëpunimit ekonomik të anëtarëve;
- Pjesëmarrje, në bashkëpunim me aktorët kryesorë të dialogut social, në përgatitjen e projektligjeve dhe akteve të tjera normative, në dhënien e kontributit për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të ekonomisë kombëtare dhe veprimtarive ekonomike, si edhe të strategjive të lidhura me punësimin dhe mbrojtjen e punësimit, arsimit profesional dhe shëndetësisë;
- Mbrojtje ligjore të të drejtave dhe interesave të anëtarëve të saj;
- Komunikim mbi veprimtarinë e Shoqatës;
- Kërkime, pranë autoriteteve publike, të të dhënave të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë statutoare;
- Reklamim dhe mbështetje formale, dhënie e informacioneve autentike ndaj personave të cilët, për arsye objektive, nuk kanë akses në informacion, janë të keqinformuar, kanë akses në informacion të gabuar mbi gjendjen socio-ekonomike në Republikën e Shqipërisë;
- Botimin, riprodhimin dhe publikimin e materialeve metodike, arsimore, shkencore për promovimin e investimeve dhe të biznesit;
- Zhvillimin, zbatimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, për të zhvilluar potencialin tregtar dhe ekonomik të Republikës së Shqipërisë dhe me qëllim arritjen e objektivave të Shoqatës;
- Lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale me persona juridike dhe fizike, për të realizuar qëllimet e përcaktuara në statut;
- Blerjen e pasurive, të luajtshme dhe të paluajtshme, të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë dhe funksionimin e duhur të Shoqatës;
- Organizimin dhe / ose pjesëmarrjen në takime, konferenca, simpoziume, kongrese, forume, tryeza të rrumbullakëta, ekspozita, seanca komunikimi të specializuara me pjesëmarrje të një publiku vendas dhe të huaj, bashkëpunim aktiv me organizata të huaja të ngjashme;
- Kontribut për mbështetjen këshill-dhënëse dhe ndihmë në fushat prioritare të Shoqatës për kompanitë dhe organizatat shqiptare;
- Kryerja e detyrave të tjera që nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për të realizuar qëllimet e përcaktuara në statut .

2.2 Në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 8788, datë 03.05.2001 "Për organizatat

jofitimprurëse”, Shoqata ka të drejtë të kryejë veprimtari ekonomike që rrjedhin nga qëllimet e saj të përcaktuara në statut dhe ekskluzivisht për arritjen e tyre.

2.3 Shoqata gjithashtu ka si qëllim të saj, analizimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kulturore, profesionale dhe morale të anëtarëve të saj dhe të të gjithë atyre që marrin pjesë në promovimin e investimeve.

2.4 Shoqata do të iniciojë dhe të marrë pjesë, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji përkatës, në zhvillimin e projektligjeve dhe akteve të tjera ligjore për mbrojtjen social-ekonomike të anëtarëve, promovimin e interesave të anëtarëve të saj, në kuadrin e institucioneve publike.

2.5 Shoqata mund të organizojë veprimtari të ndryshme për të promovuar dhe mbrojtur interesat e anëtarëve të saj. Ajo do të marrë pjesë në konferenca, seminare, simpoziume, ekspozita dhe veprimtari të tjera me interes të përbashkët.

2.6 Shoqata mund të marrë pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit të investimeve, në përgjithësi dhe të veprimtarive të tjera të lidhura.

2.7 Shoqata mund të sigurojë që të respektohet ligji dhe etika profesionale gjatë aktivitetit ekonomik dhe kërkesat e konkurrencës së ndershme ndërmjet anëtarëve të Shoqatës.

2.8 Shoqata mund të ofrojë shërbime konsulence, ekspertize dhe asistencë ligjore për anëtarët e saj.

KAPITULLI III - VEPRIMTARIA E SHOQATËS

3.1 Kuadri Rregullator: Gjate veprimtarisë së saj Shoqata i nënshtrohet dispozitave të këtij Statuti dhe të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

3.2 Të drejtat: Në mënyrë që të zhvillojë veprimtarinë e saj siç përcaktohet në këtë Statut, Shoqata do të ketë të drejtat e mëposhtme:

- I. Të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e Themeluesve dhe anëtarëve të Shoqatës, në rang kombëtar dhe ndërkombëtar;
- II. Të zhvillojë në Shqipëri të gjitha veprimtaritë e parashikuara në këtë Statut dhe veprimtari të tjera të autorizuara nga legjislacioni shqiptar;
- III. Të përfaqësojë interesat e anëtarëve të Shoqatës para autoriteteve publike dhe organizatave të tjera, si dhe para çdo personi juridik apo fizik dhe të ndërmarrë çdo veprim ligjor dhe veprime të tjera të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqatës;
- IV. Të bashkëpunojë me organizmat shtetërore në Shqipëri dhe të marrë të gjitha informacionet, dokumentet dhe aktet e tjera zyrtare të dobishme për aktivitetin e saj;

- V. Të lidhë me persona juridike dhe fizikë marrëveshje bilaterale dhe multilaterale të bashkëpunimit teknik dhe shkencor, ekonomik, financiar, industrial dhe tregtar, për kryerjen e punimeve dhe ofrimin e shërbimeve për të arritur qëllimet dhe detyrat e përcaktuara në statut;
- VI. Të hapë dhe të mbyllë llogaritë bankare, të nevojshme për veprimtarinë e saj, pranë bankave të licencuara në Shqipëri dhe jashtë vendit dhe të kryejë transaksione bankare në përputhje me kushtet kontraktuale që ajo konsideron të përshtatshme;
- VII. Të disponojë aktivet e saj dhe t'i administrojë ato në atë mënyrë që të mundësohet zhvillimi i veprimtarisë së Shoqatës dhe që të përfitohen të gjitha burimet financiare dhe materiale, të tundshme apo të patundshme;
- VIII. Të pranojë donacione, subvencione dhe sende si dhe t'i disponojë ato; të mbledhë kuotizacionet e anëtarëve të Shoqatës;
- IX. Të punësojë stafin e nevojshëm për veprimtarinë e Shoqatës – ku mund të marrin pjesë qytetarë të Republikës së Shqipërisë dhe / ose të vendeve të tjera - dhe të përcaktojë nivelin dhe kushtet e pagesës dhe kushtet kontraktuale, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;
- X. Të ushtrojë plotësisht atributet të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin mbi organizmat e punëdhënësve, konferencat, personat juridike, Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile e të Procedurës Civile, etj;
- XI. Të shpërndajë lirisht informacion në lidhje me aktivitetin e saj, të krijojë, sipas nevojës, nënndarje territoriale, të krijojë në përputhje me ligjin, ndërmarrje/kompani ose të marrë pjesë si themelues, në themelimin e kësaj të fundit për të realizuar qëllimet e përcaktuara në këtë statut;
- XII. Të lidhet me organizata ndërkombëtare, të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi në fusha të ndryshme me këto organizata;
- XIII. Të drejta të tjera të lejuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.

3.3 Detyrimet: Në mënyrë që të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me parashikimet e këtij statuti, Shoqata ka detyrimet që vijojnë:

- I. Të sigurojë zbatimin e vendimeve, dispozitave dhe udhëzimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Kryetarit të Shoqatës;
- II. Të veprojë në mirëbesim dhe në interes të anëtarëve të Shoqatës;
- III. Të paguajë taksat dhe tatimet e detyruara në favor të buxhetit të shtetit në përputhje me ligjin;

- IV. Të respektojë Kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar, normat e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me veprimtarinë e shoqatave, si dhe rregullat e vendosura nga Statuti i Shoqatës.

KAPITULLI IV - PASURIA E SHOQATËS

4.1 Kuotizacionet: Me qëllim zhvillimin e veprimtarisë të Shoqatës, Themeluesit dhe anëtarët e Shoqatës mund të japin sende dhe mjete financiare. E gjithë pasuria e Shoqatës, e cila përfshin sendet materiale dhe burimet financiare të regjistruara në bilancin e Shoqatës përbën pronën e Shoqatës. Anëtarët e Shoqatës nuk kanë të drejta pronësie mbi pasurinë e Shoqatës.

4.2 Burime të tjera të pasurisë: Burime shtesë të pasurisë së Shoqatës:

- I. Taksa e anëtarësimit dhe kuotizacionet e anëtarëve të Shoqatës. Ekzistojnë tri nivele të kuotizacioneve për t'u paguar çdo vit, si më poshtë:
 - i. 500 euro për anëtarësim të thjeshtë;
 - ii. 1.500 Euro për partnerët strategjikë;
 - iii. 5.000 Euro për anëtarët mirëbërës
- II. Donacione dhe subvencionime;
- III. Arkëtime të ndryshme që rezultojnë nga organizimi i manifestimeve publike, ekspozitave, ankandeve dhe veprimtari publike të organizuara nga Shoqata, në kuadrin e qëllimeve të parashikuara në këtë Statut;
- IV. Të ardhurat e marra nga veprimtaritë e zhvilluara nga Shoqata ose me pjesëmarrjen e kësaj të fundit, të zhvilluar në përputhje me legjislacionin shqiptar;
- V. Shpenzimet e pjesëmarrjes në kurset e trajnimit dhe zhvillimit profesional;
- VI. Burime të tjera të lejuara me ligj.

4.3 Kufizimet mbi përdorimin e të ardhurave: Të ardhurat e mbledhura nga Shoqata si vijim i veprimtarisë së saj nuk mund të shpërndahen ndërmjet anëtarëve të Shoqatës ose Themeluesve. Këto do të përdoren nga Shoqata ekskluzivisht për arritjen e qëllimeve dhe detyrave të parashikuara në këtë Statut si dhe për qëllime filantropike.

4.4 Kriteret për administrimin e pasurisë së Shoqatës: Përdorimi i të ardhurave të marra mund të parashikohet nga Kryetari i Shoqatës në buxhetin vjetor.

KAPITULLI V - ORGANIZMAT E DREJTIMIT TË SHOQATËS

5.1 Struktura organizative e Shoqatës është:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Këshilli Drejtues (Këshilli);
- Kryetari;

- Nënkryetari;
- Kryetari i Nderit;
- Sekretari i Përgjithshëm;

5.2 Organi më i lartë qeverisës i Shoqatës është **Asambleja e Përgjithshme** e anëtarëve ose e përfaqësuesve të tyre, të cilët mbledhen në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

5.3 Asambleja e Përgjithshme ka këto funksione kryesore:

- Përcakton orientimet kryesore, programet dhe fushat e veprimtarisë së Shoqatës;
- Monitoron dhe kontrollon rregullisht realizimin e orientimeve dhe të programeve;
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe administrative;
- Vendos për miratimin dhe ndryshimin e Aktit të Themelimit dhe të Statutit;
- Shqyrton dhe miraton buxhetin vjetor, raportin financiar vjetor dhe shpenzimet e parashikuara për vitin e ardhshëm;
- Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues;
- Miraton raportin e administrimit të Këshillit Drejtues;
- Vendos për riorganizimin, bashkimin dhe / ose ndarjen ose likuidimin e Shoqatës, emëron likuidatorin dhe miraton bilancin e likuidimit;
- Miraton rregullat për organizimin dhe strukturën e Shoqatës;
- Vendos për çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë e Shoqatës.

5.4 Mbledhjet e zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme thirren atëherë kur interesat e Shoqatës e kërkojnë, por jo më pak se një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Këshilli Drejtues ose Kryetari, i cili do të informojë të gjithë anëtarët e Shoqatës të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes duhet të përfshijë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Secili anëtar do të informohet për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme me letër rekomande me përgjigje për marrësin ose me e-mail.

5.5 Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme thirret nga Këshilli Drejtues ose nga Kryetari me iniciativën e tij e vet ose në mungesë të tyre nga Nënkryetari, ose me kërkesën e të paktën një të tretës së të gjithë anëtarëve të Shoqatës.

5.6 Mbledhja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme thirret të paktën dy muaj pas paraqitjes së kërkesës për të thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme e miratuar nga organet e përmendura në paragrafin 5.5 të statutit. Në rastin ku Këshilli Drejtues ose Kryetari refuzon ose heziton shprehimisht mbi thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme, organet e autorizuara kanë të drejtë të thërrasin këtë mbledhje, pa pëlqimin e Këshillit Drejtues apo Kryetarit, në përputhje me Statutin.

5.7 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime nëse janë të pranishëm, të paktën gjysma plus një nga anëtarët ose përfaqësuesit e tyre. Secili anëtar ka një votë. Vendimet miratohen me shumicën e thjeshtë të të pranishmëve, me përjashtim për vendimet mbi ndryshimet e Aktit të Themelimit dhe Statutit dhe riorganizimin dhe likuidimin e Shoqatës që do të miratohen me shumicën e përbërë nga 2 / 3 e anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar në Asamblenë e Përgjithshme. Vendimet merren me

votim të fshehtë ose publik në varësi të natyrës së vendimit (në këtë rast, është organi që ka thirrur Asamblesë që do të përcaktojë nëse natyra e vendimit është e tillë që vota e fshehtë të jetë e nevojshme ose në qoftë se shumica e anëtarëve të pranishëm apo të përfaqësuar e kërkojnë).

- 5.8** Në rast se vendimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të merren/adoptohen, organi përkatës thërret përsëri mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me të njëjtin rend dite brenda një muaji. Kjo mbledhje do të marrë vendime pavarësisht numrit të pranishmëve ose të përfaqësuesve (vendimet miratohen me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar).
- 5.9** Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë vendime vetëm për çështje të përcaktuara në rendin e ditës. Për sa i përket çështjeve që nuk janë përcaktuar në rendin e ditës, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime vetëm në rast se marrin pjesë ose përfaqësohen të gjithë anëtarët e Shoqatës.
- 5.10** Zhvillimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme pasqyrohet në një procesverbal i nënshkruar nga sekretari dhe nga Kryetari, ose në mungesë të tij nga Nënkryetari.
- 5.11** Shoqata administrohet nga Këshilli Drejtues, Kryetari i Shoqatës, Nënkryetari i Shoqatës Kryetari i Këshillit dhe Sekretari i Përgjithshëm.
- 5.12** Këshilli është organ i përhershëm drejtues i Shoqatës që varet nga Asambleja e Përgjithshme dhe ka kompetencat e mëposhtme:
- Harton strategjinë e zhvillimit dhe përcakton drejtimet kryesore të veprimtarisë së Shoqatës, duke i paraqitur ato për miratim në Asamblesë të Përgjithshme;
 - Siguron zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe i raporton Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me veprimtarinë e shoqatës;
 - Harton buxhetin e Shoqatës, raportin vjetor financiar dhe raportin në lidhje me veprimtarinë e këtij të fundit, duke i paraqitur në Asamblesë të Përgjithshme për miratim;
 - Miraton rregulloret e brendshme të Shoqatës dhe harton rregullat e strukturës së saj organizative duke i paraqitur në Asamblesë të Përgjithshme për miratim;
 - Miraton listën e stafit, propozimet për punësimin e stafit dhe të pushimeve nga puna, mënyrën e shpërblimit dhe kushtet e punës së punonjësve të Shoqatës;
 - Përcakton në përputhje me ligjin, përgjegjësinë materiale të Kryetarit të Shoqatës dhe të Përgjegjësit të Thesarit;
 - Miraton vulën, tamponin, logon dhe formularët e Shoqatës;
 - Vendos për krijimin, riorganizimin dhe likuidimin e filialeve të Shoqatës, miratimin e rregullave të tyre;
 - Menaxhon pasurinë dhe veprimtarinë e Shoqatës për zgjerimin e saj;
 - Përcakton mënyrën se si mund të përdoren dhe si mund të mblidhen donacione sipas kritereve të përcaktuara në këtë Statut;
 - Pranon dhe përjashton anëtarët e Shoqatës;
 - Vendos në lidhje me prokurimet dhe shitjen e pasurive të Shoqatës;
 - Kryen drejtimin operativ të veprimtarisë ekonomike të Shoqatës, menaxhimin e sendeve;

- Vendos mbi pjesëmarrjen e Shoqatës, si themeluese e organizatave jofitimprurëse dhe e shoqërive tregtare;
- Vendos për të gjitha çështjet që nuk janë nën kompetencën ekskluzive të organeve të tjera të Shoqatës.

5.13 Këshilli Drejtues zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë dy vjeçare. Këshilli është i përbërë nga të paktën 5 anëtarë dhe më e shumta 7 anëtarë. Në rast të dorëheqjes së drejtorëve, Këshilli ka të drejtën të zgjedhë, me shumicë të thjeshtë votash, si zëvendësues të drejtorëve të dorëhequr deri në zgjedhjet e ardhshme, anëtarët e Shoqatës. Këshilli drejtohet nga Kryetari. Mbledhjet e Këshillit janë periodike, por jo më pak se 4 (katër) herë në vit dhe diskutimet/vendimet do të mbahen/merren në gjuhën frënge. Këshilli thirret, kur është e nevojshme, nga Kryetari ose në mungesë të tij nga Nënkryetari dhe merr vendime nëse gjysma e anëtarëve janë të pranishëm. Vendimet miratohen me shumicë të thjeshtë votash. Me kërkesë të një anëtarë të Këshillit Drejtues, Kryetari i Këshillit, ose në mungesë të tij Nënkryetari është i detyruar të thërrasë, brenda 10 ditëve, një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit. Në rast se Kryetari ose Nënkryetari refuzon ose heziton shprehimisht në lidhje me thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Këshillit, anëtarë i Këshillit i cili ka kërkuar mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme ka të drejtë të thërrasë vetë mbledhjen e jashtëzakonshme pa pëlqimin e Kryetarit.

5.14 Varësia e Këshillit Drejtues të Shoqatës: Këshilli Drejtues i Shoqatës është në varësi direkte nga Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve të Shoqatës, duke qenë i detyruar të paraqesë, me kërkesën e anëtarëve, raporte në lidhje me veprimtarinë e Shoqatës, si dhe veprimtarinë e Këshillit të Shoqatës.

5.15 Kryetari i Shoqatës i cili është njëherazi edhe Kryetari i Këshillit Drejtues drejton drejtpërdrejt Shoqatën midis mbledhjeve të Këshillit Drejtues dhe ka kompetencat që vijojnë:

- Thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit Drejtues;
- Merr vendime lidhur me çdo çështje të veprimtarisë së Shoqatës dhe që nuk është kompetencë ekskluzive e organeve të tjera;
- Përfaqëson Shoqatën, pa patur nevojën e ndonjë prokure, pranë organeve gjyqësore, në marrëdhëniet me autoritetet publike dhe personat tjerë juridike dhe fizike;
- Administron mjetet e Shoqatës, realizon transaksione dhe firmos kontrata, lëshon prokura, hap llogari bankare, firmos dokumente të tjera financiare, brenda kufijve të kompetencave të tij.
- Organizon dhe drejton veprimtarinë e përditshme të Shoqatës, veprimtarinë e nëndarjeve të saj dhe siguron zbatimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli Drejtues;
- Bën propozime për punësimin dhe shkarkimin e personelit;
- Është përgjegjës për punën e sekretarisë;
- Monitoron vazhdimësinë e gjendjes kontabël dhe statistikore në përputhje me ligjin;
- Është personalisht përgjegjës për veprimtarinë e Shoqatës dhe është përgjegjës për pasurinë e saj të tundshme dhe te patundshme;
- Bën propozime për mënyrat e shpërndarjes së fondeve të mbledhura dhe merr pjesë në shpërndarjen e ndihmës humanitare apo në fusha të tjera;

- I ofron autoriteteve publike informacione të nevojshme dhe u paraqet raportet e kërkuara me ligj;
 - Nxjerr urdhra, detyrime, udhëzime;
 - Vendos mbi format dhe metodat e punës, siguron integritetin dhe përdorimin e arsyeshëm të pasurisë së Shoqatës.
- 5.16 **Zgjedhja e Kryetarit të Shoqatës:** Anëtari i Këshillit Drejtues i cili merr më shumë vota në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga Asambleja e Përgjithshme, zgjidhet Kryetar i Shoqatës për një periudhë dy vjeçare. Në rast të dorëheqjes gjatë mandatit të tij, ai zëvendësohet nga një anëtar i Këshillit, i cili zgjidhet me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Këshillit, deri në zgjedhjet e ardhshme.
- 5.17 **Varësia e Kryetarit të Shoqatës:** Kryetari i Shoqatës varet drejtpërdrejt nga Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve të Shoqatës dhe është i detyruar të paraqesë, me kërkesë të anëtarëve, të gjitha raportet mbi veprimtarinë e Shoqatës si edhe mbi veprimtarinë e tij si drejtues i Shoqatës.
- 5.18 **Nënkryetari i Shoqatës:** Anëtari i Këshillit Drejtues i cili merr më shumë vota, pas Kryetarit, gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga Asambleja e Përgjithshme, zgjidhet Nënkryetar i Shoqatës. Ai ushtron, në mungesë të Kryetarit, të gjitha të drejtat e Kryetarit, si edhe të drejta të tjera të përcaktuara sipas rregullave të strukturës organizative të Shoqatës. Termi "mungesë të Kryetarit" përfshin të gjitha pamundësitë e Kryetarit për të marrë dhe komunikuar vendimet e tij si edhe çdo mungesë fizike kur vendimet për t'u marrë kërkojnë prezencën fizike të Kryetarit. Në rast të dorëheqjes gjatë mandatit të tij, ai zëvendësohet nga një anëtar i Këshillit, i zgjedhur me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Këshillit, deri në zgjedhjet e ardhshme.
- 5.19 **Kryetar Nderi i Shoqatës:** Roli i Kryetarit të Nderit të Shoqatës i rezervohet Shkëlqesisë së tij Ambasadorit të Republikës franceze në Republikën e Shqipërisë. Funkcioni i Kryetarit të Nderit të Shoqatës mund t'i propozohet nga Kryetari i Shoqatës Shkëlqesisë së Tij Ambasadorit francez në Shqipëri, në detyrë. Kjo procedurë do të përsëritet çdo herë që do të emërohet një Ambasador i ri i Republikës franceze në Republikën e Shqipërisë.
- 5.20 **Atributet e Kryetarit të Nderit të Shoqatës:** Kryetar i Nderit të Shoqatës ka funksionet e mëposhtme:
- Merr pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme pa të drejtë vote.
- 5.21 **Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës:** Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës emërohet nga Kryetari dhe nënkryetari i Shoqatës, pas miratimit të Këshillit për një periudhë të pacaktuar. Ai mund të revokohet në çdo kohë nga Kryetari.
- 5.22 **Atributet e Sekretarit të Përgjithshëm:** Sekretari i Përgjithshëm është punonjës i përhershëm i Shoqatës, përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së përditshme të Shoqatës, dhe nëndarjeve të saj dhe siguron zbatimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli, Kryetari dhe Nënkryetari. Sekretari i Përgjithshëm do të ketë kompetencat e përcaktuara nga Kryetari në emërimin e tij.

5.23 Këshilli i parë përbëhet nga personat e mëposhtëm për një periudhë dy vjeçare:

- Z. Julien Roche, rezident në Bul. "Dëshmoret e Kombit" Kullat Binjake, Kulla 2, Tiranë, Shqipëri;
- Z. Hubert Saint-Jean, rezident në Rruga "Ismail Qemali" Samos Tower, Kati 5, Tiranë, Shqipëri;
- Z. Genc Boga, rezident në Rruga "Dëshmoret e 4 Shkurtit", Kompleksi Green Park, Tiranë, Shqipëri;
- Z. Edvin Murati, rezident në Lagjja 3, Rr Ferit Xhajku, Pallat 63 / 2, Ap 2, Tiranë, Shqipëri;
- Z. Aleksander Xhuvani, rezident në Rruga « Themistokli Gërmenji », Nr. 10, H.2 Ap.20, Njësia Bashkiake Nr.2 1010 Tirane, Tiranë, Shqipëri;
- Znj. Elisabeth Gjoni, rezidente në Autostrada Tiranë - Durrës km.3, Kashar, Tiranë, Shqipëri;
- Z. Jean-Alain Jouan, rezident në Rruga "Qemal Stafa", Ish TIPOGRAFIA Ushtarake, Tiranë, Shqipëri.

5.24 Kryetari i parë i Shoqatës është Z. Julien Roche dhe Nënkryetari i parë është Z. Hubert de Saint-Jean, të cilët do të ushtrojnë këto funksione për një periudhë dy vjeçare.

KAPITULLI VI - VITI FINANCIAR

6.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

6.2 Përrjashtim: Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon në datën e themelimit të Shoqatës dhe përrfundon më 31 dhjetor të atij viti.

KAPITULLI VII - ANËTARËT E SHOQATËS

7.1 Anëtarët e Shoqatës: Anëtarët e Shoqatës mund të jenë, mbi baza vullnetare, çdo person juridik, drejtor kompanie në Republikën e Shqipërisë ose jashtë vendit, i cili ushtron veprimtari sipërmarrëse në çfarëdo fushe qoftë, si edhe çdo person fizik, drejtor kompanie në Republikën e Shqipërisë ose jashtë vendit, në përputhje me ligjet dhe institucionet e interesuara në zhvillimin e investimeve dhe punësimit në Shqipëri, pas validimit të kandidaturave të tyre nga Kryetari (pas konsultimeve me Këshillin).

7.2 Të drejtat e anëtarëve të Shoqatës: Anëtarët e Shoqatës kanë të drejtë:

- Të propozojnë për shqyrtim nga organet drejtuese të Shoqatës çështje që lidhen me veprimtarinë e Shoqatës;
- Të kërkojnë mbështetjen e Shoqatës në marrëdhëniet me autoritetet e administrimit publik qendror dhe lokal dhe me organizmat e organizata të tjera

shtetërore, si edhe me persona juridikë të cilët zhvillojnë një veprimtari sipërmarrëse;

- Të marrë pjesë në prezantime, ekspozita informative dhe të natyrave të tjera dhe seminare të organizuara nga Shoqata;
- Të largohen nga Shoqata;
- Të financojnë projektet dhe programet e Shoqatës.

7.3 Detyrimet e Anëtarëve të Shoqatës: Anëtarët e Shoqatës janë të detyruar:

- Të respektojnë këtë Statut dhe vendimet e organëve drejtuese të Shoqatës;
- Të paguajnë tarifën e regjistrimit dhe kuotizacionet vjetore;
- Të zhvillojnë biznesin e tyre në kuadër të ligjit dhe rregullave tregtare;
- Të përmbushin detyrimet e tjera të parashikuara me ligj.

7.4 Pranimi i anëtarëve të rinj të Shoqatës: Pranimi i anëtarëve të rinj është përgjegjësi e Këshillit Drejtues të Shoqatës. Vendimi për pranimin e anëtarëve të rinj merret pas një votimi me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Këshillit të pranishëm ose të përfaqësuar.

7.5 Largimi nga Anëtarësia: Cilësia e anëtarit të Shoqatës anulohet në rastet e mëposhtme:

- Likuidimi i personit juridik, anëtar i Shoqatës;
- Tërheqje vullnetare e anëtarit të Shoqatës;
- Mosrespektimi i detyrimeve si një anëtar i Shoqatës.

KAPITULLI VIII - HYRJA NË FUQI, NDRYSHIME DHE AMENDAMENTE

8.1 Hyrja në fuqi: Dispozitat e këtij Statuti do të kenë efekt ligjor menjëherë pas regjistrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe efektet e saj pushojnë në momentin e prishjes së Shoqatës në Regjistrin e organizatave jofitimprurëse.

8.2 Modifikime dhe amendamente: Çdo ndryshim apo amendament të këtij statuti dhe aktit të themelimit të Shoqatës do të miratohet nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme me votën e të paktën 2 / 3 e anëtarëve të pranishëm të Shoqatës apo të përfaqësuarve dhe të hyjnë në fuqi menjëherë pas regjistrimit. Çdo modifikim i rregullores së përdorimit të brendshëm do të miratohet nga Këshilli.

KAPITULLI IX - MBARIMI I VEPRIMTARISË SË SHOQATËS (BASHKIMI, NDARJA DHE LIKUIDIMI)

9.1 Shoqata mbyll veprimtarinë e saj nga: riorganizimi apo prishja, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas kushteve të caktuara nga ky Statut.

9.2 Riorganizimi i Shoqatës bëhet, konform ligjit, me anë të shkrirjes (bashkim, përhithje) ose shpërbërjes (ndarja). Riorganizimi prodhon efekt vetëm pas regjistrimit tek Regjistri i

organizatave jo fitimprurëse. Riorganizimi kryhet pas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës. Shoqata mund të bashkohet me një shoqatë tjetër. Kryetari duhet të përgatisë projektin e bashkimit ose të ndarjes që duhet të mbajë informacionet e caktuara në nenin 36 të ligjit nr. 8789 të datës 07.05.2011, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse".

- 9.3 **Prishja me inisiativë të Shoqatës** mund të ndodhë në rastin kur qëllimet e Statutit nuk mund të realizohen për mungesë të mjeteve ose të përmbushjes së objektivave të Statutit.
- 9.4 **Shoqata mund të likuidohet** sipas vendimeve të marra nga gjykata në rastet e përshkruara nga legjislacioni shqiptar.
- 9.5 **Prishja me inisiativë të vetë Shoqatës** ndiqet nga procedura e likuidimit. Shoqata do të përdorë gjatë procesit të likuidimit emërtimin e saj të ndjekur nga fjalët "në likuidim e sipër" Likuidimi i Shoqatës kryhet nga një ose disa likuidatorë të caktuar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 9.6 **Kryetari** depoziton në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës një kërkesë lidhur me regjistrimin e fillimit të procesit të likuidimit të Shoqatës.
- 9.7 **Likuidatori** ka të drejta dhe detyrime të cilat nuk bien në kundërshtim me qëllimin e likuidimit. Likuidatori pezullon veprimtarinë e Shoqatës, mbledh kreditë nga debitorët, shet aktivet, përmbush kërkesat e kreditorëve dhe shpërndan aktivet e mbetura, në përputhje me dispozitat ligjore dhe statutore.
- 9.8 **Likuidatori** përgatit bilancin e likuidimit, në të cilin ai përcakton vlerën dhe përbërjen e aktiveve të mbetura dhe e paraqet për miratim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 9.9 **Aktivitet e mbetura**, pas përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve nuk mund t'u shpërndahen anëtarëve të Shoqatës dhe anëtarëve të organeve të saj dhe i transferohen një organizate tjetër me qëllime të ngjashme me ato të përcaktuara në këtë Statut.
- 9.10 Likuidatori është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj kreditorëve neqoftëse ai nuk i ka plotësuar detyrimet e tij, ka shpërndarë aktivet e Shoqatës përpara se të përmbushë detyrimet ndaj kreditorëve ose ka shkelur ligjin apo Statutin e Shoqatës.
- 9.11 Likuidatori është përgjegjës për dëmin e shkaktuar Shoqatës nga veprimet e tij.

KAPITULLI X - ANËTARËT E PARË – THEMELUESIT

Anëtarët të parë të "CLUB D'AFFAIRES FRANCE - ALBANIE" janë personat e mëposhtëm, juridikë dhe fizikë:



- Green Technologies, regjistruar më 16/12/2008, NIPT K82416004J, me seli në: Bul. Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 2, përfaqësuar nga Z. Julian Roche;
- Societe Generale Albania sh.a., regjistruar më 24/02/2004, NIPT K41424801U, me seli në: Bul. Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 9, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Hubert Saint-Jean;
- Z. Genc Boga, Managing Partner i Boga & Associates, firmë ligjore dhe kontabiliteti NIPT K01419003F, Adresa: Rruga Deshmoret e 4 Shkurtit, Kompleksi Green Park, Tirane, Shqiperi, PO Box 8264;
- Z. Jean-Alain Jouan; Adresa: Rruga "Qemal Stafa", ish Tipografia Ushtarake, Tirane, Shqiperi;
- Z. Edvin Murati; Adresa: Lagja 3, Rr Ferit Xhajku, Pallat 63/2, Ap 2, Tirana, Shqipëri
- Institut Francais de Gestion, rregjistruar më 1 nentor 1998 NIPT J61929020JT me seli në, "Bul. Deshmoret e Kombit "Universiteti Politeknik i Tiranës, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Aleksander Xhuvani;
- Amadeus, regjistruar më 26/02/1997, NIPT J72118005P, me seli në: Autostrada Tirane Durres km.3, Kasharë - Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Znj. Elizabeth Gjoni.

NË BAZË TË NENEVE PËRFSHIRA SI MË LART, Statuti i Shoqatës "CLUB D'AFFAIRES FRANCE-ALBANIE" miratohet nga anëtarët e parë - themeluesit e Shoqatës dhe nënshkruar më 27.10. 2011.

NËNSHKRIMET E THEMELUESIVE/ ANËTARËVE TË PARË TË SHOQATËS:

Green Technologies
Përfaqësuar nga Julian Roche

Societe Generale Albanie Sh.A.
Përfaqësuar nga Hubert de Saint-Jean

Genc Boga

Jean-Alain Jouan

Edvin Murati

Aleksander Xhuvani



Amadeus
Përfaqësuar nga Elizabeth Gjoni

P. Murati
E. Gjoni

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr. 12898 Rep.



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Vërtetohet se Z. Oltion Spiro, banues në Tiranë, madhër e me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje, bëri përkthimin e dokumentit bashkangjitur nga gjuha frënge ne gjuhen shqipe dhe nënshkroi në prezencën time. Unë Noteri e vërtetoj sipas Ligjit Nr. 7829, datë 01/06/1994 e Udhëzimi Nr. 6291, datë 17/08/2005, i Ministrisë së Drejtësisë, pika 3,4,7.

Tiranë, më 04/11/2011

Noter
Julian ZHELEGU



REPUBLIQUE D'ALBANIE
CHAMBRE DU NOTARIAT, TIRANA
No. 12898 Rep.

ATTESTATION DE SIGNATURE

Nous certifions que, M. Oltion Spiro, domiciliée à Tirana, majeure et jouissant de pleine capacité d'agir, personnellement connue par moi, a réalisé la traduction du présent document de la langue française en langue albanaise et a signé en bonne et due forme en ma presence conformément à la loi. Moi, le notaire l'atteste selon la loi No. 7829, du 01/06/1994, Ordonance No. 6291, le 17/08/2005 du Ministère de la Justice, articles 3,4,7.

Tirana, le 04/11/2011

Notaire
Julian ZHELEGU